

OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A.
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: Shoqërine “SHANSI INVEST” sh.p.k, me adrese: Farke e Madhe, Sauk, Tirane dhe me Nr. NIPT J 61924002 T.

Procedura e prokurimit: “Procedurë “E hapur- pune”

Numri i referencës së procedures: **REF-85843-09-14-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Objekti i prokurimit është **“Rikonstrukcion i kabinave elektrike murature, Fiderat A6, A7, A11, A12, A14, A15 NST Rajonal Tirane 220/20 kV”**, me fondin limit total **120,257,060 (njqind e njezet milion e dyqind e pesedhjetë e shtatë mijë e gjashtedhjetë)** leke pa TVSH dhe me afat realizimi 4 (kater) muaj nga data e dorezimit të sheshit nga mbikqyresi.

Publikime të mëparshme: Nuk ka.

Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 38 date 24.09.2018.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Njoftojmë se, ka qënë pjesëmarrës në procedurë Operatorët Ekonomik me vlerën përkatëse të ofruara:

- **OE: “BE-IS” sh.p.k, me NIPT K71412003A** e cila ka paraqitur një ofertë ekonomike me vlerë **112,025,143** (njqind e dymbedhjetë milion e njezet e pesë mijë e njeqind e dyzet e tre) leke pa tvsh.
- **OE: “SHANSI INVEST” sh.p.k, me NIPT J 61924002 T** e cila ka paraqitur një ofertë ekonomike me vlerë 112,431,731 (njqind e dymbedhjetë milion e katerqind e tridhjetë e një mijë e shtatëqinde e tridhjetë e një) leke pa tvsh.
- **OE: “ERGI” sh.p.k, me NIPT K02727229P** e cila ka paraqitur një ofertë ekonomike me vlerë 114,299,847 (njqind e katermbedhjetë milion e dyqind e nentëdhjetë e nente mijë e teteqinde e dyzet e shtatë) leke pa tvsh

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. OE **“ERGI” sh.p.k** që me shkresën Nr. 20344 Prot, datë 01.11.2018, ka kërkuar tërheqjen nga oferta pasi makineritë dhe stafi janë të angazhuara në kontrata të tjera. KVO ka pranuar kërkesën dhe nuk ka bërë vlerësimin e ofertes së subjektit **“ERGI” sh.p.k.**
2. KVO ka vendosur të skualifikojë OE **“BE-IS” sh.p.k** pasi:

1.Ne DST, Shtojca 12, “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, pika 2.3.1 për “Kapacitetin Teknik dhe Profesional, pika c, ku Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin teknik (autorizim prodhuesi/distributori, Teste, katalog) të kërkuar për listën e materialeve. Nga kontrolli i dokumentacionit të paraqitur rezulton:

Për artikujt:

- **Cela të motorizuara**
- **Cele transformatori**
- **Cele linje**
- **Kabllo XLPE**

I gjithë dokumentacioni teknik i paraqitur nga OE me perjashtim të Autorizimit të Prodhuesit është në gjuhë të huaj, duke qenë në kundërshtim me kërkesat e DST ku gjuha e përdorur në ofertë duhet të jetë gjuha shqipe.

2.Makinerite e deklaruar në këtë procedurë prokurimi, rezultojnë të njëjtat me makinerite të angazhuara në kontratën me objekt “Ndërtimi Fiderit 20 KV C19 të Nënstacionit 110/20/6 KV Traktora Kabina të reja dhe kabina rikonstruksion si dhe Linja TU me Kabell ABC (Punetori)” të lidhur me Autoriteti Kontraktor Drejtoria Rajonale Tirane OSHEE sh.a.

3.Referuar ekstraktit QKB të OE rezulton se ky i fundit ka ushtruar aktivitet tregtar në Uren Vajguore Berat për gjatë vitit 2018, por nuk dorezon vërtetim për taksat vendore pranë kësaj njësie Administrative.

4.Referuar kontratës individuale të punës të punëmarresit Ilmi KOLA (drejtues teknik i deklaruar për këtë objekt), paga e tij bruto rezulton 50.000 leke në muaj. Ndërsa referuar listepageses së 12 muajve të fundit, paga e tij bruto rezulton në 40.000 leke në muaj.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë **SHANSI INVEST” sh.p.k,** me adresë: Farke e Madhe, Sauk, Tirane dhe me Nr. NIPT J 61924002 T, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **112,431,731(njëqind e dymbëdhjetë milion e katërqind e tridhjetë e një mijë e shtatëqind e tridhjetë e një)** lekë pa TVSH, pikët totale të mara 100 pike, është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, me adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë, (Drejtoria e Sherbimeve Mbeshtetëse, Njësia e Prokurimit) kopjen e nënshkruar të formularit të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj siç parashikohet në nenin 58 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2007 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 06.11.2018

Ankesa: Nuk ka